

**R E L A C I O N**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN**

**“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10465, DATË  
29.9.2011 “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË  
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është që, nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të bëhet e mundur zbatimi i reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i kuadrit ligjor për unifikimin e shërbimit veterinar duke mundësuar kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR, pasi me miratimin e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e qeverisjes vendore nuk i kanë më këto struktura. Për këtë qëllim, ky projektligj ka për objektive të forcojë masat parandaluese dhe të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve nëpërmjet forcimit të strukturave të kontrollit dhe shërbimit për të garantuar mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA  
POLITIKE**

Ky projektakt del si nevojë në plotësimin e kuadrit ligjor në lidhje me kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR dhe vakume ligjore të ndryshme duke synuar përmirësime në kuadrin ligjor në mbështetje të punës së shërbimit veterinar në arritjen e objektivave dhe standarteve të BE-së të përcaktuara në politikat dhe strategjitë e Qeverisë në tërësi dhe MBZHR në veçanti.

Ky projektligj është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave në vitin 2018.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME  
PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Incidentet e ndodhura në të kaluarën në fushën e shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve, të cilat kanë lënë pasojë domethënëse në shëndetin publik, për shkak të transmetimit të sëmundjeve zoonotike apo edhe të lëndëve mbetëse të dëmshme të cilat gjenden në produktet ushqimore me origjinë shtazore, kanë treguar se një organizim i mirë i shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies, mund të shmangte në një nivel të lartë këto incidente. Në vendin tonë ky zinxhir komande është i shkëputur për shkak të fragmentizimit të shërbimit veterinar midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Për këtë qëllim ky projektligj parashikon unifikimin e zinxhirit të komandës në linjë vertikale duke bërë të mundur kryerjen e funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit vendor nga shërbimi veterinar rajonal. Në këtë mënyrë plotësohet edhe rekomandimi i vazhdueshëm i dhënë në Raportin e Progresit të Komisionit European si dhe të misionit të OIE-së në vitin 2014 në Shqipëri, për vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave të shërbimit veterinar, i cili rekomandoi se “është i një rëndësie kritike rishikimi i roleve dhe përgjegjësi të Ministrisë së Brendshme-Veterinerëve të Bashkive; duke konsideruar shumë të rëndësishëm transferimin e tyre në Shërbimin Veterinar Shtetëror pasi sigurohet kapaciteti teknik dhe menaxhues i Shërbimit Veterinar Shtetëror”.

Projektligji parashikon forcimin e kontrollit të therjes së kafshëve nëpërmjet kalimit të kontrollit shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes nga veterinerit zyrtar i shërbimit veterinar rajonal duke eliminuar në këtë mënyrë shkëputjen e hallkës së kontrollit të shëndetit të kafshës para dhe pas therjes. Lëvizja e kafshëve të gjalla dhe tregtimi i tyre në tregun e kafshëve të gjalla, e cila është njësi epidemiologjike, janë burim kryesor i transmetimit dhe përhapjes së sëmundjeve nëse nuk përfshihen në kontrollin brenda standardeve të zinxhirit të kontrollit të shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve. Për këtë qëllim projektligji parashikon që edhe kontrolli i tregjeve të kafshëve të gjalla të përfshihet në detyrat e veterinerit zyrtar të shërbimit veterinar rajonal. Për herë të parë, në zbatim të rekomandimeve Raportit të Progresit të Komisionit European dhe të Projektit të BE-së PAZA, projektligji parashikon zbatimin e masave për biosigurinë në ferma me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë dhe/ose objekt, zonat ose çdo ambienti tjetër dhe mjetet e transportit”. Që nga viti 2016 kryerja e masave profilaktike shtetërore dhe identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve iu delegua klinikave veterinare private të kontraktuara. Nga vlerësimi i punës së tyre për punën e kryer në lidhje me detyrat e deleguara rezultoi se kryerja e masave profilaktike shtetërore dhe identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve nuk garantohej sipas standardeve dhe strategjive në fuqi në një masë të konsiderueshme. Konstatim të njëjtë kanë edhe ekspertët e projekti PAZA. Për këtë qëllim projektligji parashikon kryerjen e shërbimeve në shëndetin e kafshëve nga shërbimi veterinar rajonal. Veterinerët zyrtar që do të kryejnë këto funksione do

të jenë më afër fermerit, në çdo njësi administrative, përgjegjës për ofrimin e shërbimit në zbatim të strategjive për sëmundje të ndryshme, mbajtjen nën kontroll të situatës epizootike si dhe të lëvizjes së kafshëve në njësinë ku është përgjegjës. Projektligji parashikon që shërbimi veterinar rajonal të ketë edhe funksione kontrolli ndër të cilat përfshihet edhe monitorimi i zbatimit të shërbimeve. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të shërbimit veterinar rajonal është parashikuar të bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Projektligji për herë të parë parashikon që AKU, në raste të konstatuar ose të dyshimta për mospërputhje me standardet e sigurisë ushqimore dhe që shkak mund të jetë kafsha e gjallë, për të vlerësuar shkakun e origjinës, mund të kryej gjurmin në fermën e kafshëve të gjalla. Në këtë rast, shërbimi veterinar rajonal mbështet AKU-në.

Me qëllim kalimin e plotë të kompetencave në kontroll dhe vendimmarrje në PIK për ngarkesat me kafshë të gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor që importohen, eksportohen ose tarrizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë është riformuluar neni përkatës për t'ia kaluar këtë kompetencë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, i cili është autoriteti përgjegjës për pikat e inspektimit kufitar.

Projektligji përmirëson dispozitat në lidhje me qendrën kombëtare të referencës, ISUV, duke i dhënë edhe statusin e institucionit kërkimor shkencor. Rregullorja Evropiane 882/2004/EC përcakton që qendra e referencës duhet të kryejë kërkime shkencore në fushën për të cilën ajo është referencë. Nga ana tjetër, ISUV duhet të përgatitet për hyrjen në rrjetin evropian të laboratorëve të referencës me hapjen e negociatave me BE-në.

Në kuadër të derregullimit projektligji përmirëson procedurat e regjistrimit në Republikën e Shqipërisë të Produkteve Mjekësore Veterinare duke reduktuar kohën e regjistrimit nga 210 ditë në 100 ditë.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në këtë projektligj ka 47 nene të cilat kanë përmbajtje si më poshtë:

- Në nenin 1 propozohen ndryshime në nenin 1 të ligjit “Qëllimi” duke shtuar pikën 12 që përcakton rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të transmetueshme të kafshët ose njerëzit duke bërë të mundur vendosjen e masave urgjente që duhen marrë në rast të shpërthimit të një sëmundje. Për të arritur këtë janë të domosdoshme, klasifikimi sipas prioritetit dhe kategorizimi i sëmundjeve, hyrje dalja, garantimi i lëvizjes dhe gjurmueshmërisë së ngarkesave të kafshëve, produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum human.
- Në nenin 2 propozohen ndryshime në nenin 2 të ligjit “Objekti”, duke shtuar pikën 4 si objekt për arritjen e qëllimit të shtuar në nenin 1 dhe shprehet qartësisht se, “Kafshët me pronar ose jo, kafshët e egra, produktet embrionale, produktet me origjinë shtazore jo për konsum human, subjektet, mjetet e transportit, pajisjet, si dhe çdo material, i cili ndikon ose është i prirur të ndikojë në përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme të kafshëve”
- Në nenin 3 propozohen ndryshime në nenin 3 të ligjit “Fusha e zbatimit të ligjit” duke ndryshuar gërmën ç të këtij neni më qëllimin për të qartësuar fushën e zbatimit të ligjit, e cila duket e paqartë sepse në terminologjinë e fushës së bujqësisë fermeri është qendra e referencës, ndërkohë që kemi përfshirë në fushën e zbatimit të gjitha veprimtaritë e tjera veprimtarisë veterinarë.
- Në nenin 4 propozohen ndryshime në 4 të ligjit “Përkufizimet” janë shtuar disa përkufizime; “Biosiguria”, si koncept i paratur në legjislacionin Europian si tërësi masash që reduktojnë rrezikun e hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve. “Hetim epidemiologjik”, është zbulimi i origjinës së mundshme të një sëmundje me qëllim përcaktimin e shkaqeve dhe ecurinë e zhvillimit të sëmundjes. "Sistemi i informacionit të epidemiologjise veterinarë" është sistemi elektronik i njoftimit të menjhershëm për çdo njoftim epidemiologjik për përshpejtimin e masave që duhen marrë në kohë reale. “Stabiliment” është një objekt, ndërtesë ose strukturë në të cilën kryhet të paktën një nga aktivitetet e përmendura në këtë ligj. “Survejance” është mbledhja e vazhdueshme sistematike e informacionit me qëllim që të merren masat përkatëse. “Teknik veterinar”, si përkufizim jo i plotë në në ligjin ekzistues lidhur me autoritetin që e autorizon duke shtuar këtë edhe për shërbimin veterinar rajonal.
- Në nenin 5 propozohen ndryshime në nenin 6 të ligjit “Identifikimi i kafshëve të prodhimit”, është bërë pasi tek kafshët e prodhimit që i nënshtrohen identifikimit të detyrueshëm nuk ishin përfshirë kafshët njëthundrake (kuajt, mushkat gomerët). Identifikimi i këtyre kafshëve

është shumë i rëndësishëm pasi njëhundrakët preken nga disa sëmundje zoonotike (që trasetohen edhe tek njeriu), si dhe sëmundje të tjera infektive të tyre. Identifikimi i tyre do të ndihmojë që në rastet e shfaqjes së një sëmundje të njëhunrakëve të mund të gjurmohet ferma e origjinës si dhe fermat ku mund të ketë lëvizur kjo kafshë. Në këtë mënyrë mund të parandalohen, zbulohen dhe kontrollohen sëmundjet infektive të njëhundrakëve. Në kushtet e mbarshimit në ferma të vogla ato mund të bëhen burim i përhapjes së sëmundjes nga një fermë në tjetrën edhe sëmundjeve që prekin lloje të tjera të kafshëve. Gjithashtu identifikimi i kafshëve njëhundrake mundëson hartimin e programeve të monitorimit të sëmundjeve të tyre. Aktualisht është e miratuar rregullorja për identifikimin e kafshëve njëhundrake, e cila ka përafuar rregulloren përkatëse të BE-së. Identifikimi dhe monitorimi i sëmundjeve infektive të njëhunrakëve janë dy pikat kyç për të filluar plotësimin e kriterëve për eksportin e njëhundrakëve në vendet e Bashkimit Europian, një nga prioritetet e ministrisë së bujqësisë me interes për fermerët dhe ekonominë e vendit. Ndryshimi i propozuar në pikën 3 të nenit 6, në përputhje edhe me pikën 1 të këtij neni, i japin ministrit kompetencën për të urdhëruar identifikimin e detyrueshtëm të llojeve të tjera të kafshëve për të parandaluar, zbuluar dhe kontrolluar sëmundje infektive.

- Në nenin 6 propozohen ndryshime në nenin 7 të ligjit “Financimi i sistemit IR” duke shfuqizuar pikën dy të këtij neni lidhur me VKM për miratimin e kostos financiare që do të paguajnë fermerët për sistemin e IR dhe ndryshimin e pikës 3 të këtij neni duke i dhënë ministrit përgjegjës për veterinarinë autoritetin për përcaktimin e tarifave për funksionimin e sistemit të IR.
- Në nenin 7 propozohen ndryshime në nenin 9 të ligjit “Funksionet e veterinerit zyrtar në identifikimin e kafshëve të prodhimit” ku me qëllimin human për të mbrojtur jetën e kafshëve të cilat si pasojë e veprimeve të papërgjegjshme të pronarëve të tyre lëvizin të paidentifikuara nga vëndorigjina të cilat, pika 1,b e këtij neni parashikon eliminimin brenda 72 orëve, por njëkohësisht për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe njerëzve nga përhapja e sëmundjeve të mundshme infektive dhe zoonotike që mund të kenë prekur këto kafshë, ato futen në kushte karantine në karantinën shtetërore ose në vendin e destinacionit, jo më pak se 21 ditë, për të kryer ekzaminimet e nevojshme veterinare. Shpenzimet për egzaminimet dhe ditët e qëndrimit në karantinë i ngarkohen pronarit të kafshëve. Ky ndryshim ligjor ul gjithashtu dëmin financiar që pëson pronari i kafshëve si dhe koston financiare për gruposjen e karkasave të kafshëve që do të eliminohen. Gjithashtu në këtë nen janë parashikuar eliminimi i kafshëve në rastin kur kafshët kalojnë ilegalisht kufirin, kur pronarët refuzojnë të mbulojnë koston për qëndrimin e kafshëve në karantinë, si dhe kur kafshët janë të sëmura me

sëmundje infektive ose zoonotike dhe eliminimi i tyre është i detyrueshëm.

- Në nenin 8 propozohen ndryshime në nenin 12 të ligjit “Identifikimi i qenve” ku nga identifikimi i “qenve” të bëhet në “kafshët e shoqërimit”, kjo do të mundësojë që të përfshihen në identifikimin edhe llojet e tjera të kafshëve të shoqërimit (psh. macet, qelbësat, brejtësit, lepujt, reptilët, etj.) të cilët shoqërojnë pronarët e tyre dhe mbahen në ambientet shtëpiake. Këto kafshë, bazuar e dhe në rregulloren përkatëse të miratuar në përputhje me pikën 4 të këtij neni që është përafrim i rregulloreve përkatëse të BE-së në legjislacionin Shqiptar për lëvizjen për qëllime jo tregëtare të kafshëve të shoqërimit si dhe forma e identifikimit dhe modeli i pasaportës së kafshëve të llojit qen dhe mace.
- Në nenin 9 propozohet ndryshimi në nenin 14 të ligjit “Lista e sëmundjeve” ku përcakton që autoriteti kompetentë plotëson listën e sëmundjeve sipas pikës 1 të këtij neni me sëmundje e reja bazuar në prioritetet kombëtare..
- Në nenin 10 propozohen ndryshime në nenin 15 të ligjit “Masat e përgjithshme profilaktike” ku krahas masave të përgjithshme profilaktike shtohen edhe masa shtesë të kontrollit të sëmundjeve të cilat merren bazuar në rrethanat epidemiologjike, llojin e fermave dhe stabilimenteve, vendndodhjet, prodhimin, llojet dhe kategoritë e kafshëve të përfshira si dhe kushtet ekonomike ose sociale. Këto masa shtesë për kontrollin e sëmundjes miratohen me urdhër Ministri.
- Në nenin 11 propozohet ndryshimi në nenin 16 të ligjit “Programet vjetore të monitorimit” ku përcaktohet që autoriteti kompetent përgatit programet vjetore të profilaksisë veterinarë shtetërore, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve me pasoja për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik veterinar, mbështetur në situatën epidemiologjike në vend.
- Në nenin 12 propozohet ndryshimi në nenin 20 të ligjit “Veprimet në rastin e dyshimit” ku në pikën 3 përcaktohet që Veterineri zyrtar merr kampionet dhe i dërgon në laboratorin veterinar, të përcaktuar për sëmundjen që dyshohet dhe lajmëron në sistemin e informacionit të epidemiologjisë veterinarë .
- Në nenin 13 propozohet që pas neni 20 të ligjit shtohet neni 20/1 në të cilin përcaktohen masat paraprake profilaktike në rastin e dyshimit të një sëmundjeje infektive. Kjo mundëson që shërbimi veterinar të ndërmarë paraprakisht, përpara konfirmimit të një sëmundjeje infektive, masa të mbështetura në ligj, për kontrollin dhe parandalimin e përhapjen e sëmundjes infektive të mundshme.

- Në nenin 14 propozohet që në nenin 21 të ligjit “Masat me konfirmimin e sëmundjes” të ndryshohet pika 7 duke përcaktuar që ministri miraton rregulloret përkatëse për masat që duhet të zbatohen për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve sipas situatës në fermën e vendosur nën mbikëqyrje zyrtare për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, dhe jo një rregullore siç është aktualisht. Legjislacioni i BE, nga i cili kemi përafruar dhe vazhdojmë të përafrojmë rregulloret përkatëse për sëmundjet infektive dhe zoonotike.
- Në nenin 15 propozohet ndryshimi në nenin 30 të ligjit “Kontrollet zyrtare sanitare veterinare” pasi në nenin 129 të ligjit autoriteti kompetent ka si kompetencë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Në nenin 16 propozohet që në pikën 2 të nenit 30 të ligjit “Kontrollet zyrtare sanitare veterinare” fjala “garanton” zëvendësohet me fjalën “mbikëqyr” pasi në kompetencat e Autoritetit kompetent që përcaktohen në nenin 129 autoriteti kompetent ka për detyrë që të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji.
- Në nenin 17 propozohen ndryshime në nenin 43 të ligjit “Urdhrat për PIK-në në rastet e sëmundjeve” në të cilat përcaktohet që ministri, bazuar në Kodin Shëndetësor të Kafshëve të Tokës dhe të Ujit, të OIE-së, me propozim të autoritetit kompetent, miraton dhe shfuqizon urdhrat për ndalimin e importit dhe të transitit në Republikën e Shqipërisë të ngarkesave me kafshë të gjalla, produkte mjekësore veterinare, produkte embrionale të kafshëve, produkte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor, të cilat mund të transmetojnë një sëmundje infektive ose të rrezikojnë shëndetin e njerëzve ose kafshëve.
- Në nenin 18 propozohet riformulimi i nenit 48 të ligjit “Masat e autoritetit kompetent” duke përcaktuar Ministrin si autoriteti që vendos për marrjen e masave për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, në të cilat përfshihen eliminimi i kafshëve të sëmura, të dyshuara të sëmura, ose të ekspozuara kundrejt infeksionit, asgjësimin e kadavrave, produkteve të kafshëve, produkteve embrionale, të lëndëve të papërpunuara dhe të pajisjeve e mjeteve në një vatër të sëmundjes, që paraqet rrezik për shëndetin e kafshëve. Zbatimi i masave përfshin edhe kosto financiare të cilat bazuar në nenin 45 pika 3 është kompetencë e ministrit të urdhërojë përdorimin e buxhetit.
- Në nenin 19 propozohet një ndryshim në nenin 49 të ligjit “Masat e autoritetit kompetent” duke shfuqizuar togfjalëshin “në zbatim të vendimit të marrë nga autoriteti kompetent” pasi eliminimi kryhet në bazë të strategjisë përkatëse së miratuar për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes.

- Në nenin 20 propozohen ndryshime në nenin 51 të ligjit “Detyrat e pronarit dhe të kujdestarit” në të cilin shtohen detyrat për pronarët ose kujdestarët e kafshëve të prodhimit lidhur me masat e biosigurisë në fermë, sipas llojeve dhe kategorive të kafshëve, llojit të mbarështimit si dhe parashikohet miratimi i rregullores nga ministri për masat e biosigurisë në fermë. Biosiguria në fermë është një masë parandaluese shumë e rëndësishme dhe e detyrueshme në vendet e BE për parandalimin e futjes ose përhapjes së sëmundjeve infektive, duke bërë të mundur edhe minimizimin e dëmtimeve në kafshë dhe humbjet financiare të fermerëve dhe buxhetit të shtetit për veterinarinë. Gjithashtu është përcaktuar që ministri miraton rregullat për masat e biosigurisë që zbatohen në fermë.
- Në nenin 21 propozohen ndryshime në nenin 54 të ligjit “Funksionet e njësive të qeverisjes vendore” pasi me miratimin e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë më struktura veterinarë. Zbatimi i reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i kuadrit ligjor për unifikimin e shërbimit veterinar duke mundësuar kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal për në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR. Në këtë nen përcaktohet bashkëpunimi i njësive të qeverisjes vendore dhe shërbimit veterinar lidhur me zbatimin e masave profilaktike, funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla dhe kullotave, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, kontrollin e qenve dhe maceve të rrugës, kontrollin në ambientet publike për vendosjen e maskës mbrojtëse tek kafshët e shoqërimit agresive dhe marrjen e masave përkatëse si dhe përcakton vendgroposjen dhe eliminimin e kadavrave të kafshëve, rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve.
- Në nenin 22 propozohet ndryshimi i pikës 3 të nenit 58 të ligjit “Gjurmueshmëria e certifikatave shëndetësore veterinarë” ku përcaktohet që autoriteti kompetent mbikqyr dokumentat mjekësore veterinarë për përputhjen e tyre me kërkesat e përcaktuara për procedurën e lëshimit të tyre gjë që është në përputhje me nenin 129 të ligjit në të cilin përcaktohet se autoriteti kompetent ka si kompetencë mbikqyrjen e zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Në nenin 23 propozohen ndryshime në nenin 61 të ligjit “Ekspozitat dhe panairët” pasi me ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj nuk do të ketë më struktura veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore ndaj detyrimi i subjekteve organizatore të ekspozitave dhe panairëve, kur këto organizime bëhen jashtë mjediseve të stallave dhe stabilimenteve, është të njoftojnë paraprakisht me shkrim shërbimin veterinar rajonal për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të aktivitetit si dhe miratimi ose refuzimi i



kërkesës për kryerjen e këtyre veprimtarive bëhet nga Shërbimi veterinar rajonal.

- Në nenin 24 propozohet ndryshimi i pikës 3 të nenit 62 të ligjit “Detyrimet gjatë transportit” pasi me ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj nuk do të ketë më struktura veterinare në njësitë e qeverisjes vendore ndaj përcaktohet detyrimi i Veterinerit zyrtar të urdhërojë eliminimin e detyrueshëm në vend për kafshët me dëmtime të rënda dhe njoftimi i autoritetit kompetent dhe njërive të qeverisjes vendore.
- Në nenin 25 propozohen ndryshime në nenin 63 të ligjit “Grumbullimi dhe tregtia e lëkurëve” nëpërmjet të cilave sanksionohet që Personi fizik apo juridik që grumbullon, tregton apo përpunon ose jo lëkurë kafshësh vërteton dhe dokumenton origjinën e lëkurëve të blera përmes certifikatës veterinare të origjinës, ky dokumentacion regjistrohet dhe ruhet për një periudhë 3-vjeçare.
- Në nenin 26 propozohet që pas nenit 64 të ligjit shtohet neni 64/1 ku përcaktohen rregullat për lëvizjen e kafshëve të egra tokësore kur lëvizin nga një vendbanim në Shqipëri në një vendbanim tjetër në Shqipëri, ose në një shtet tjetër. Gjithashtu në këtë nen përcaktohet që kafshët e egra gjatë lëvizjes të shoqërohen me një certifikatë shëndetësore ose dokumente të tjera veterinare të përcaktuara nga Autoriteti kompetent, dhe ku certifikimi i shëndetit të kafshëve është i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e shëndetit të kafshëve për lëvizjet e parashikuara. Përcaktim tjetër në këtë nen është dhe miratimi me urdhër të ministrit të Rregullave të hollësishme për lëvizjen e kafshëve të egra. Në ligj aktualisht nuk ka asnjë referencë ligjore për rregullat e lëvizjes së kafshëve të egra tokësore. Ndryshimet e propozuara e plotësojnë këtë vakum ligjor.
- Në nenin 27 propozohet ndryshimi i pikës 3 të nenit 85 të ligjit “Tregtimi i produkteve mjekësore veterinare” duke qartësuar që vetëm medikamentet që janë regjistruar dhe tregëtohen në një nga vendet e BE si dhe ato me certifikatë EMA pranohen për tu regjistruar dhe tregëtuar në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu në pikën 4 të këtij neni përcaktohet që si afat për lëshimin e certifikatës së tregëtimit do të jetë brenda 10 ditë pune pas pagesës nga kërkuesi të tarifës së përcaktuar për regjistrim
- Në nenin 28 propozohet ndryshimi i pikës 1 të nenit 87 të ligjit “Procedura për miratimin e tregëtimit të PMV-ve” duke shkurtuar si afat për miratimin nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve nga 210 ditë që ishte në 100 ditë, kjo me qëllimin që të përshpejtohen procedurat në ndihmë të subjekteve që kërkojnë të regjistrojnë dhe tregtojnë PMV në Republikën e Shqipërisë.

- Në nenin 29 propozohen ndryshime në nenin 102 të ligjit “Sistemi i farmako-vigjilencës” duke përcaktuar si kritere për përdorimin e PMV-ve karakteristikat dhe profilin e sëmundjes, përhapjen e sëmundjes në vënd dhe në vende fqinje nga ka ardhur sëmundja, efikasitetin dhe rreziqet që paraqesin këto PMV në mirëqenien e kafshëve, pasojat ekonomike, sociale dhe ndikimi mjedisor që sjell sëmundja. Rregullat mbi përdorimin e këtyre PMV-ve miratohen me urdhër Ministri. Gjithashtu autoriteti kompetent duhet të marrë masat e duhura për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik në lidhje me përdorimin e PMV-ve për studime shkencore.
- Në nenin 30 propozohen ndryshime në nenin 105 të ligjit “Zbatimi i praktikës mjekësore veterinarë” duke ndryshuar në titull termin “Zbatim” me termin “Ushtrim” pasi në këtë nen sanksionohen se cilët persona mund të ushtrojnë praktikën mjekësore veterinarë.
- Në nenin 31 propozohet ndryshimi i pikës 1 të nenit 106 të ligjit “Kryerja e veprimtarive veterinarë” nëpërmjet të cilit cilësohet se veprimtaritë veterinarë mund të kryhen edhe nga veterinerët zyrtarë, persona fizikë që kryejnë praktikën mjekësore veterinarë (mjekët veterinarë, farmacistët veterinarë, teknikët veterinarë (me arsim parauniversitar), teknikët e ndërzimit (inseminatorët), laboratorët veterinarë, fermat blegtorale, parqet dhe kopshtet zoologjike e të tjera.
- Në nenin 32 propozohet që në nenin 108 të ligjit “E drejta e ushtrimit të profesionit” togfjalëshi “praktikës mjekësore veterinarë” të ndryshohet në “profesionit të mjekut veteriner” pasi në këtë nen bëhet fjalë se cilët persona mund të ushtrojnë profesionin e mjekut veteriner.
- Në nenin 33 propozohet që në nenin 109 të ligjit “Mjekët veterinarë” të bëhen ndryshimet në pikën 1 paragrafi i parë “1. Mjekët veterinarë mund të ushtrojnë profesionin në sektorin veterinar privat” ndryshon në “Mjekët veterinarë mund të ushtrojnë profesionin në shërbimin veterinar shtetëror ose sektorin veterinar privat” në këtë mënyrë u jepet e drejta e munguar edhe mjekëve veterinerë të shërbimit veterinar shtetëror të ushtrojnë profesionin e tyre. Gjithashtu në pikën 2, në fund të fjalisë “autoriteti kompetent” zëvendësohet me “Ministri” për të përcaktuar që ministri është autoriteti që përcakton modelin e vulave për mjekët veterinarë që ushtrojnë profesionin e tyre.
- Në nenin 34 propozohet që në nenin 112 të ligjit “Teknikët veterinarë” në pikën 2, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “të miratuar me urdhër Ministri” për të mundësuar që ministri të mund të miratojë rregulloren për teknikët e ndërzimit.
- Në nenin 35 propozohet ndryshimi i nenit 114 të ligjit “Klinika dhe spitali veterinar” duke shuar një pikë ku përcaktohet kompetenca e ministrit për

të miratuar rregulloren për funksionimin e Klinikave dhe Spitaleve veterinare. Aktualisht nuk ka një rregullore për funksionimin e tyre sepse mungonte baza ligjore për miratimin e saj.

- Në nenin 36 propozohen ndryshimi i nenit 116 të ligjit “Veprimtaritë e deleguara të klinikës veterinare”, sepse nuk mund të ketë më veprimtari të deleguara të klinikës veterinare. Ky nen do të riformulohet si një nen me titull “Shërbimi veterinar në raste emergjente dhe krize” dhe në këtë nen sanksionohet që në raste të tilla, kur shërbimi nuk mund të përballohet nga strukturat shtetërore, thirren të kryejnë këtë shërbim nëpërmjet kontraktimit të atyre që ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë në fushën e veterinarisë.
- Në nenin 37 propozohen shfuqizimi i nenit 117 të ligjit “Kontrata për delegimin e veprimtarive” pasi ky kontraktim do të kryhet vetëm në raste raste emergjente dhe krize dhe në bazë të legjislacionit përkatës për këto lloj kontratash.
- Në nenin 38 propozohen shtimi i pikës 4 në nenin 122 të ligjit “Veprimtaria e laboratorëve veterinarë” në të cilën përcaktohen dispozitat për masat në lidhje me biosigurinë dhe të izolimit biologjik nga laboratorët që përdorin agjentë patogjenë me qëllim kërkimin shkencor, edukimin, diagnostikimin ose prodhimin e vaksinave ose produkteve të tjera biologjike. Këto masa vendosen me qëllim administrimin korrekt për ndalimin e përhapjes së agjentëve patogjene në kafshë të gjalla dhe mjedis.
- Në nenin 39 propozohen ndryshime në nenin 123 të ligjit “Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare”. Për të mundësuar që Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të rikthehet në statusin që ka pasur nga viti 2004 deri në miratimin e ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”. Në përcaktimet e ligjit nr. 9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar” ky institucion emërtohej Instituti i Kërkimeve Veterinare (IKV) dhe ka qënë institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. IKV ishte qendër reference laboratorike kombëtare, pjesë e rrjetit të shërbimit veterinar kombëtar, dhe kryente punë kërkimore shkencore. Ai gjithashtu ka pasur pavarësi në veprimtarinë e vet financiare për shërbimet që kryente. Në këtë nen përcaktohet që mënyra e organizimit dhe funksionimit të ISUV përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit dhe se pagat për punonjësit e ISUV do të përcaktohen sipas statusit të punonjësve me grada dhe tituj shkencorë.
- Në nenin 40 propozohen ndryshime në nenin 127 të ligjit “Shërbimi veterinar” duke shtuar shprehjen “ vartësi vertikale” për qartësuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit veterinar dhe

përcaktimit se shërbimi veterinar drejtohet nga autoriteti kompetent i përcaktuar në këtë ligj.

- Në nenin 41 propozohet riformulimi i nenit 128 të ligjit “Përbërja e shërbimit veterinar” nëpërmjet të cilave përcaktohet se shërbimi veterinar kombëtar përbëhet nga autoriteti kompetent, shërbimi veterinar rajonal në strukturat përkatëse të ministrisë dhe shërbimi veterinar privat. Shfuqizimi i pikës 4 shfuqizon përcaktimin e strukturave veterinare në njësitë e qeverisjes vendore pasi ato nuk do të jenë më dhe shërbimi që ato ofrojnë do të ofrohet nga shërbimi veterinar rajonal. Gjithashtu në këtë nen përcaktohet që organizimi dhe funksionimi i shërbimit veterinar rajonal përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Në nenin 42 propozohen shtimi i gërmës j në nenin 129 të ligjit “Kompetencat e autoritetit kompetent” në të cilën përcaktohet shërbimin veterinar me qëllim ndihmën për të siguruar zbatimin e akteve ligjore në fuqimund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Policinë e Shtetit.
- Në nenin 43 propozohet riformulimi i nenit 130 të ligjit “Fusha e veprimtarisë së veterinerit zyrtar” duke e titulluar këtë nen “Fusha e veprimtarisë së shërbimit veterinar rajonal” duke përcaktuar fushën e veprimtarisë së këtij shërbimi si dhe duke e zgjeruar atë edhe me fushën e veprimtarisë së strukturave veterinare të qeverisjes vendore si dhe funksionet që aktualisht bazuar në nenin 54 i kanë ata. Po kështu në këtë nen shtohet edhe pika 2 që përcakton se Shërbimi veterinar rajonal duhet të mbështesë autoritetin përgjegjës për kontrollin e ushqimeve gjatë kryerjes së detyrave të ngarkuara me ligj.
- Në nenin 44 riformulimi i nenit 131 të ligjit “Veterineri zyrtar” e ndajnë aktivitetin e veterinerit zyrtar në fushën e kontrollit dhe në fushën e shërbimit. Fusha aktuale e kontrollit plotësohet për kontrollet në thertore, tregjet e kafshëve të gjalla dhe kullota, njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe mbledhjen, grumbullimin dhe groposjen e kadavrave të kafshëve, funksione këto të cilat aktualisht, bazuar në nenin 54, i kanë strukturat veterinare të qeverisjes vendore. Fusha e shërbimeve plotësohet me shërbimet që shërbimi veterinar do ti ofrojë komunitetit në lidhje me zbatimin praktik të masave të programeve të profilaksisë shtetërore për sëmundjet në kafshë si dhe identifikim regjistrimin e kafshëve të gjalla të mbarshuara në ferma sipas llojeve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji.
- Në nenin 45 propozohen shtimi i nëndarjes vi. në nenin 134 të ligjit “Kundërvajtjet administrative” ku përcaktohen masat për kundërvajtjet administrative, kur veprohet në kundërshtim me masat e përgjithshme profilaktike dhe prodhimin e PMV-ve në vend, kundërvajtje të cilat nuk janë të përcaktuara më parë në këtë nen.

- Në nenin 46 propozohet ndryshimi i nenit 137 të ligjit “Licencimi i veprimtarive” i cili përcakton që licencimi, anulimi ose shfuqizimi i licencës për veprimtaritë e kryera për qëllime të natyrës ekonomike, tregtare, profesionale dhe çdo natyre tjetër të ngjashme, përveç atyre të natyrës vetjake, që parashikohen në këtë ligj do të kryhen sipas kategorive e nënkategorive respektive të fushës II të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se veterineri zyrtar përveç ndëshkimit për shkeljet e konstatuara dhe kur vëren se masat korigjuese nuk janë zbatuar brënda afatit i dërgon menjëherë autoritetit kompetent procesverbalin e inspektimit dhe propozimin për anulimin ose shfuqizimin e licencës së aktivitetit të subjektit. Autoriteti kompetent brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit të subjektit të inspektimit merr vendimin për anulimin ose shfuqizimin e licencës së aktivitetit.
- Në nenin 47 përcaktohet hyrja në fuqi e ligjit.

Sqaromë se në këtë projektligj janë shtuar nenet 3, 4 pika 5, 6, 7, 16, 17, 2 pikat 1/b dhe 2, 25, 27, 30, 31, 31, 33, 34, 36, 39, 40, 41, 43, 44, të cilat nuk kanë qënë përfshirë në draftin e dërguar për mendim MD, MFE, MSHMS, MB, si dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar, ka përgatitur këtë projektligj.

Ky projektligji iu dërgua për mendim Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të cilat janë shprehur si më poshtë:

**Ministria e Brendshme** ka sugjeruar që germa j e nenit 28 në projektligj të ndryshohet si vijon “ *Bashkëpunon dhe lidh marrëveshje me Policinë e Shtetit, në zbatim të akteve ligjore në fuqi*”. Ky mendim është reflektuar në projektligj që me ndryshimet është germa j e nenit 42 të projektligjit.

**Ministria e Drejtësisë** është shprehur dakort me këtë projektligj.

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë.** Mendimet e kësaj ministrie janë reflektuar si vijon:

- Lidhur me pikën e parë të komenteve për vlerësimin e shpenzimeve buxhetore sqarojmë që kosto eventuale është e pasqyruar në Formatin standart - Për efektet financiare në buxhetin e shtetit nga projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”
- Lidhur me pikën e dytë të komenteve sqarojmë që ky projektligj u dërgua në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Qeverisjen Vendore.
- Lidhur me pikën e tretë të komenteve mbi argumentimin e arsyeve të kalimit të funksioneve të shërbimit veterinar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore tek pushteti qendror sqarojmë:

Në këtë mënyrë Shërbimi Veterinar është i copëzuar në shërbimin veterinar në njësitë e vetëqeverisjes vendore i cili kryen kontrollin e kafshëve të gjalla në tregjet e kafshëve dhe në thertore dhe shërbimin veterinar në MBZHR. i cili kryen të gjitha masat dhe kontrollet në fermat dhe në transportin e kafshëve të gjalla, ky fragmentizim i shërbimit veterinar është vërejtur edhe nga Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit të Kafshëve (OIE) në “Raportin mbi Shërbimin Veterinar Shqiptar”, raport vlerësimi pas misionit të auditit të kryer nga ata në periudhën 2 -13 Qershor 2014 e cila ka rekomanduar unifikimin e të gjithë shërbimit veterinar në një strukturë të vetme “zinxhir komande”

Reforma e shërbimit veterinar dhe unifikimi i strukturës veterinare të njësisve të qeverisjes vendore dhe shërbimit veterinar është mbështetur nga Bashkimi Europian (Delegacioni Europian në Shqipëri) reformë kjo e lançuar në datë 16 Tetor 2015 nga MBZHRAU në një takim me prezencën e Zëvendës Kryeministrit Z. Niko Peleshi dhe Ambasadores së Bashkimit Europian në Shqipëri Znj. Romana Vllahutin). Përsa mësipër në ligjin organik 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në strukturat e vetëqeverisjes vendore nuk u parashikua që të ketë shërbim veterinar si pjesë të tij.

- Lidhur me pikën e tretë të komenteve mbi “sistemin e informacionit të epidemiologjisë veterinare” sqarojmë që ky është pjesë e sistemit të informacionit blegtoral dhe veterinar “RUDA” i cili është në funksion që prej vitit 2011, por shtohet si përkufizim në ligj.
- Lidhur me pikën e katërt të komenteve bashkëngjitur këtij relacioni është Formatin Standart për efektet financiare në buxhetin e shtetit me tabelën me koston financiare që sjell projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

**Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore** është shprehur sa vijon:

- Lidhur me pikën e parë të sugjerimeve për shtimin e pikës b në nenin 54 me përmbajtjen “Bashkëpunon me autoritetin kompetent dhe strukturat e shërbimit rajonal veterinar për zbatimin e ligjit për veterinarinë në funksionimin e tregjeve publike, rrjetit të tregëtisë dhe kullotave” sygjërimi është reflektuar në projektligj.
- Lidhur me pikën e dytë të sugjerimeve për riformulimin e pikës c) “mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë kërkesat e këtij ligji për kontrollin veterinar të qenve dhe maceve të rrugës, duke bashkëpunuar me strukturat rajonale veterinare” sygjërimi është reflektuar në projektligj.
- Lidhur me pikën e tretë të sugjerimeve për përcaktimin “Strukturat rajonale veterinare shtrijnë shërbimin veterinar në të gjithë njësitë e nësitë e vetëqeverisjes vendore”, sygjërimi është reflektuar duke bërë ndryshimin në nenin 40 të projektligjit.
- Lidhur me pikën e katërt të sugjerimeve për vendimin e këshillit të Ministrave për përgjegjësi të përbashkëta për mbetjet toksike të produkteve blegtorale, të tregjeve e thertoreve dhe për bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për kontrollin veterinar të qenve dhe të maceve të rrugës, sygjërimi është reflektuar duke bërë ndryshimin në nenin 17 të projektligjit

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.** Mendimet e kësaj ministrie janë reflektuar si vijon:

- Lidhur me pikën e parë të sugjerimeve për “Sistemin e Informacionit Veterinar” sqarojmë që ky përkufizim nuk mund të vendoset pasi nuk është i cituar në asnjë nen të ligjit.
- Lidhur me pikën e dytë të sugjerimeve për njehsimin me definicionin e OIE-së, sqarojmë që është në përputhje me atë definicion. Termat survejancë aktive dhe pasive janë teknik dhe përkufizohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
- Lidhur me pikën e tretë të sugjerimeve për vendosjen e terminologjisë “prioritetet kombëtare”, sygjërimi është reflektuar duke bërë ndryshimin në nenin 7 të projektligjit.
- Lidhur me pikën e katërt të sugjerimeve për bashkëpunimin dhe njoftimin e ISHP-së dhe strukturave të shëndetit publik këto janë të sanksionuara në ligj përkatësisht:

Neni 22 pika 3 “Në rastin e shfaqjes së zoonozave, shërbimi veterinar rajonal njofton autoritetin kompetent për sigurinë ushqimore dhe atë të shëndetit publik rajonal”

Neni 22 pika 6 “Autoriteti kompetent njofton ministrin, organet administrative shtetërore të shëndetësisë, të mbrojtjes së mjedisit, organet kompetente për emergjencat civile dhe publikun, kur një sëmundje paraqet një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, si dhe i informon për masat më të rëndësishme për parandalimin e sëmundjes”

Neni 131 gërma c “Në rastet e sëmundjeve zoonotike, informon , informon AKU dhe strukturat përkatëse të shëndetit publik”

- Lidhur me pikën e pestë të sugjerimeve sqarojmë se as në ligj as në projektligj në nenin 18 (aktualisht neni 24 i projektligjit) nuk ka gërmë “f”, përse i përket pikës 3 të projektligjit sqarojmë që nuk ka të bëjë me sëmundje zoonotike por për kafshët me dëmtime të rënda dhe të pashërueshme.
- Lidhur me pikën e gjashtë të sugjerimeve për ndalimin e përhapjes në njerëz sqarojmë që kjo është e shprehur që tek neni 1 pika 3 e ligjit si qëllim i ligjit për shërbimin veterinar.
- Lidhur me pikën e shtatë të sugjerimeve sqarojmë se në këtë rast bëhet fjalë për marrëveshje me Policinë e Shtetit, për njoftimin e strukturave të shëndetit publik më sipër është sqaruar (pika 4).

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i ndryshimeve ligjore të sipërpërmëndura ka kosto financiare shtesë.

1. Shtesa nga Buxheti i Shtetit me nivel të kostove shtesë vjetore është 176,640 mijë lekë dhe në nivel mujor 14,553 mijë lekë, kjo për rreth 230 veterinerë që kalojnë në shërbimin veterinar rajonal nga njësitë e qeverisjes vendore.

2. Shtesa nga Buxheti i Shtetit me nivel të kostove shtesë vjetore është 114,240 mijë lekë dhe në nivel mujor 9,520 mijë lekë, kjo për rreth 170 veterinerë që të rekrutohen në shërbimin veterinar rajonal. Ky efekt financiar do të mbulohet nga fondi që i kalonte klinikave veterinare private për detyrat e deleguara.

3. Shtesa nga Buxheti i Shtetit me nivel të kostove shtesë vjetore është 6.722 mijë lekë dhe në nivel mujor 560 mijë lekë, kjo për rreth 24 punonjës shkencor të ISUV, që mbajnë gradën shkencore “Doktor”. Përfitimi i kësaj shtesë kërkon ndërhyrje në VKM nr. 187, datë 15.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve,



gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, pasi punonjësit shkencor janë deri në nivelet specialist me titull e grada.

Nga pushteti vendor, për 230 veterinerët e njësive të qeverisjes vendore, bashkë me funksionet do të transferohet edhe buxheti përkatës për pagat e tyre. Për veterinerët zyrtar që do të kryerjnë shërbimet si fondi i nevojshëm për pagat e tyre do të përdoret fondi nga buxheti për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, programi buxhetor “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, fondi për veterinarinë, i cili aktualisht përdoret për punën veterinare për kryerjen e masave profilaktike. Pjesa tjetër do të parashikohet në PBA 2020 - 2022.

Bashkëngjitur këtij relacioni është Formatu Standart për efektet financiare në buxhetin e shtetit me tabelën me koston financiare që sjell projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**MINISTRI**

**NIKO PELESHI**